



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:094579

Datë: 18.03.2025

Numri i dokumentit: 07007877

C.nr.2254/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Shpresa Veselaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: A. D, R. A, N. A, Xh. S, dhe H. P, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson B. P, Avokat nga Mitrovica, Rruga Blv.I. B, nr.xx, K x, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, me seli në Prishtinë, Rruga “Luan Haradinaj” p.n., të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti, kompensim i pagës së 13-të, kompensimin e shujtave dhe pagës jubilarë, jashtë seancës gjyqësore me datë 17.03.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

P a s h q y r t i m k r y e s o r t ë ç ë s h t j e s

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: A. D, R. A, N. A, Xh. S. dhe H. P.
- II. DETYROHET** e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, që paditësve t’ia paguajë shumat si në vijim:
 - A. D, në emër të shpërblimit të pagës së 13-të për fundvitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, (për çdo vit shumën prej 732.92 €) t’ia paguaj shumën prej 2,931.68 €, si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite, përvojë pune në vlerë të 25 %, të një page mesatare të vitit 2022, shumën prej 142.00 €, e në shumë të përgjithshme prej 3,073.68 €.
 - R. A, në emër të shpërblimit të pagës së 13-të për fundvitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, (për çdo vit shumën prej 580.89 €) t’ia paguaj shumën prej 2,323.56 €, si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite, përvojë pune në vlerë të 25 %, të një page mesatare të vitit 2022, shumën prej 142.00 €; e në shumë të përgjithshme prej 2,465.56 €.
 - N. A, në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, (për çdo vit shumën prej 639.38 €) t’ia paguaj apo shumën prej 2, 557.52 €, si

dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite, përvojë pune në vlerë të 25 %, të një page mesatare të vitit 2022, shumën prej 142.00 €, e në shumë të e përgjithshme prej 2,699.52 €.

- Xh. S, në emër të shpërblimit të pagës së 13-të për fundvitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, (për çdo vit shumën prej 383.45 €) t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1, 533.80 €.
- H. P, në emër të shpërblimit të pagës së 13-të për fundvitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, (për çdo vit shumën prej 563.25 €) t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2,253.00 €.

E të gjitha këto me kamatë ligjore në shkallë prej 8 % e cila do të llogaritet nga marrja e këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 724.00 €, në afat prej 7 ditësh nga marrja këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve mbi shumat e gjykuara, që ka të bëjë për kompensimin e shujtave ditore nga 3 € për 740 ditë pune, për periudhën nga data 14.11.2018 e deri me datë 23.02.2022, për secilin veç e veç nga 2,200.00€ si dhe refuzohen në tërësi kërkesa e paditësve: Xh. S, dhe H. P, me të cilën kanë kërkuar 25% e pagës bazë në emër të pagës jubilarë, edhe atë veç e veç në shumë prej 142.00 €, si kërkesa të pabazuara.

A r s y e t i m

Paditësit përmes përfaqësuesit të tyre, me datë 19.05.2021 kanë paraqitur padi, kundër të paditurës, për kompensimin e pagës së 13-të, shujtës ditore dhe pagës jubilarë, duke theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura. Më tej ka shtuar se meqënëse e paditura nuk ka përmbushur obligimin e saj ndaj paditësve, ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësve në tërësi si të bazuar si për nga baza dhe lartësia.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura me datë 08.12.2022 ka parashtruar përgjigje në padi, , me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, me arsyetim se e njëjta është e palejuar sepse paditësit nuk i kanë shterur mjetet e brendshme të ankimit, ashtu siç parashihet me nenin 78 paragrafi 1 dhe 2 Ligjit Nr.03/L-212 të Punës. Po ashtu ka deklaruar se e njëjta nuk është realizuar për asnjë punonjës së Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Ka shtuar se Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-125, neni 20 paragrafi 4 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë, çdo nismë, duke përfshirë edhe atë lidhur me nenin 29 pika 2 të UA nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar,

ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore – financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të. Më tej e paditura thekson se kërkesa e paditësve për pagën e 13-të, vlen vetëm brenda mundësive buxhetore të punëdhënësit-të paditurës dhe asnjë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar si detyrim. Me propozim për gjykatën që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, e që në këtë rast rezulton se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar për arsye se:

Me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) përcaktohet se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*.

Ndërsa për pjesën tjetër të kërkesëpadiës, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 399 sipas të cilit *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se: Në mes të palëve ndërgjyqëse rezulton se nuk ishte kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimet e punësimit të bashkangjitura shkresave të lëndës.

Nga vërtetimet e punësimit, të cilave gjykata ju fali besimin me rastin e vendosjes, gjykata konstatoi se paditësi i parë A, D, sipas Vërtetimit me nr. ref. 04/1-02SRR/346/2021 realizon pagën mujore në lartësi prej 732.92 € si dhe është punësuar tek e paditura me datë 01.07.2002, paditësi i dytë R. A, sipas Vërtetimit me nr. ref. 04/1-02SRR/253/2021 realizon pagën mujore në lartësi prej 580.89 € si dhe është punësuar tek e paditura me datë 08.01.2001, paditësi i tretë N. A, sipas Vërtetimit me nr. ref. 05/1-102/ 160/2021 realizon pagën mujore në lartësi prej 749.27 € si dhe është punësuar tek e paditura me datë 20.11.2000, paditësi i katërt Xh. S, sipas Vërtetimit me nr. ref. 04/1-02SRR/413/2021 realizon pagën mujore në lartësi prej 383.45 € si dhe është punësuar tek e paditura me datë 01.08.2005, si dhe paditësi i pestë H. P, sipas Vërtetimit me nr. ref. 04/1-02SRR/276/2021 realizon pagën mujore në lartësi prej 563.25 € si dhe është punësuar tek e paditura me datë 07.04.2003.

Gjykata vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ nr. 01/2021, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës për kërkesat e aprovuara të paditësit, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagës së 13-të.

Me nenin 29 paragrafi 2 të UA nr.02/2018 përcaktohet se: “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.

Me nenin 30 paragrafi 2 të UA nr.01/2021 përcaktohet se: “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”.

Nga interpretimi i dispozitave të lart cituara të Udhëzimeve Administrative, të nxjerra nga e paditura, dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, sepse paditësit gëzojnë të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik ta përfitojnë si shpërblim një pagë mujore, e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësit e të paditurës, në këtë rast paditësit, të kenë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës, nëse nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës. Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit të performancës, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësit, kanë vlerësim të kënaqshëm, të performancës dhe të njëjtit nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, për gjatë viteve: 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje, me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësve për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj ndonjërit prej paditësit.

Gjykata vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim sipas dispozitave të lart cituara, që t’ ia kompensoi paditësve, pagat e 13-ta, për fund vitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, si dhe paditësit 1,2 dhe 3 shpërblimin jubilar për 10 vite përvojë pune. Ndaj paditësit e kanë cilësinë e kreditorëve ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në të cilin përcaktohet se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura ju ka mbetur borxh paditësve me aplikimin e dispozitave të lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve të ju kompensoi shumat e gjykuara, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, e cila do të llogaritet nga marrja e këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive.

Përpos kësaj Gjykata e aprovoi kërkesën e paditësve: paditësit të parë A. D, paditësit të dytë R. A, dhe paditësit të tretë N. A, për kompensimin e shpërblimit jubilar në shkallën prej 25% të pagës bazë, për vitin jubilar për 10 vite përvojë pune, e që në këtë rast zbatohet neni 29 paragrafi 5 i UA nr.02/2018 dhe UA nr. 01/2021, në të cilin përcaktohet se: “Personeli policor që është në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Policinë e Kosovës iu takon shpërblimi në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës pas çdo dhjetë (10) vite pune (paga jubilarë)”, pasi që të njëjtit e kanë arritur vitin jubilar në vitin: 2020, 2021 dhe 2022, rrjedhimisht në kohën kur udhëzimet në fjalë ka qenë në fuqi.

Ndërsa Gjykata e refuzoi kërkesën e paditësve veç e veç në lidhje me shujtat ditore të kërkuara për periudhën nga data 14.11.2018, e deri me datë 23.02.2022, për 740 ditë pune, nga 3.00 €, për secilin veç e veç nga 2,220.00€, e në shumë të përgjithshme prej 11,000.00 €, pasi që e njëjta kërkesë mbështetet në paragrafin 1 të nenit 29 të UA nr.02/2018 si dhe të nenit 30 paragrafi 1 të UA nr.01 /2021, ku përcaktohet se: “Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”, andaj dispozitat ligjore të lart cituar nuk e detyrojnë shprehimisht të paditurën për kompensimin e shujtave ditore ashtu siç kanë kërkuara paditësit, ndaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Po ashtu Gjykata e refuzoi pjesën e kërkesës së paditësit të katërt dhe paditësit të pestë, për kompensimin e shpërblimit jubilar në shkallën prej 25% të pagës bazë, edhe atë sipas interpretimit dispozitës së nenit 29 paragrafi 5 i UA nr.02/2018, në të cilin përcaktohet se: “Personeli policor që është në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Policinë e Kosovës iu takon shpërblimi në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Policinë e Kosovës pas çdo dhjetë (10) vite pune (paga jubilarë)”, gjykata ka vlerësuar se paditësi i katërt Xh. S, ka filluar punën tek e paditura me datë 01.08.2005, ashtu që vitin jubilar e ka arritur në vitin 2015, po ashtu paditësi i pestë H. P, ka filluar punën tek e paditura me datë 07.04.2003, ashtu që vitin jubilar e ka arritur në vitin 2013, rrjedhimisht kur udhëzimet administrative për marrëdhënien e punës tek e paditura, nuk ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi në fjalë e ka arritur vitin jubilar.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara. E paditura nuk mund ta mënjanoi detyrimin, me pretendim se detyrimet financiare nga Udhëzimi Administrativ, se nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, sepse këto akte në këtë rast Udhëzimi Administrativ i lartcekur, është aprovuar nga struktura të larta të të paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë, kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuar, nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësit, duke u thirrur në ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat e lartcekura për derisa e paditura me asnjë provë shkresore-analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç kanë kërkuar paditësit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata është në dispozitën nenit 449 dhe 452 e LPK-së, sipas të cilave paditësit ju pranohet shpenzimet në shumë prej 724.00€ (624.00 € në emër të përpilimit të padisë dhe 100.00€ taksën për padi), ndërsa refuzoj pjesën tjetër të shpenzimeve pasi që të njëjtat, nuk kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në këtë gjykatë, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 453 par.1 të LPK-së.

Për këto shkaqe dhe arsye, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr. 2254/21 datë 17.03.2025

Gjyqtarja
Shpresa Veselaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.